

Qeveria zvicerane ndihmon Kaçanikun për shtim të hyrash nga tatimi në pronë

Nis regjistrimi i objekteve të paregjistruara

KAÇANIK, 18 QERSHOR - Qeveria zvicerane është përcaktuar për ta ndihmuar Kaçanikun për shtim të hyrash nga tatimi në pronë. "Ka nisur së zbatuari projekt i përegjistrimin e pronave të paregjistruara në territorin e Komunës së Kaçanikut", ka theksuar Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës të Kaçanikut, të shtunën. Ai ka thënë se projekt është duke u financuar nga programi LOGOS i Qeverisë zvicerane përmes mbështetjen e qeverisjes lokale dhe decentralizimit në Kosovë. "Personat e aftësuar përegjistrim pronash kanë nisur punën në terren", ka nën vizuar zëdhënësi Dullovi. Pohimet e tij i ka konfirmuar Rexhep Luma, njëri nga 5 anëtarët e ekipit të aftësuar për regjistrimin e objekteve që nuk figurojnë në bazën e të dhënave të Zyrës së Përherershme të Tatimit në Pronë. "Më 15 qershori kemi nisur punën në terren, ndërsa paraprakisht i jemi nënshtruar aftësimit 2-javor edhe për përdorimin e teknikës së avan-



cuar GPRS për regjistrim objektesh", ka theksuar Luma. Ai dhe 4 kolegët e tij ishin kontraktuar nga LOGOS-i për 5 muaj. Ndërkëq zyrtarë përgjegjës komunalë kanë deklaruar se projekt i sipërpër-

mendur do ta ndihmojë Komunën e Kaçanikut në shtimin e të hyrave buxhetore nga tatimi në pronë. "Pronarët e objekteve që do të regjistrohen nga ekipi i LOGOS-it do t'i marrin saturat e tatimit në pronë më 2012", ka theksuar Xhelal Dema, menaxher i Zyrës së Përherershme të Tatimit në Pronë. Ai ka pohuar se do të regjistrohen edhe objektet e reja të pafinalizuara. "Këto objekte do të tatimohen me 40 për qind të shumës së paraparë për objektet e banueshme me hapësirë të njëjtë", ka theksuar Dema.

19 QERSHOR 2011

Ekrem Raka